



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E BRENDSHME  
AGJENCIA E BLERJEVE TË PËRQENDRUARA**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.  
2018

Tiranë, më \_\_\_\_.

**FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT**

**Për: Lotin I. “Blerje autoambulancë modeli A”**

Operatorin ekonomik “ALBANIA MOTOR COMPANY” shpk me adresë: Autostrada  
Tiranë - Durrës, km 8, Tiranë.

Procedura e prokurimit: “Procedurë e hapur”

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-82577-08-09-2018

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Loti I. “Blerje autoambulancë modeli A” me fondin limit  
184.095.170 (njëqind e tetëdhjetë e katër milion e nëntëdhjetë e pesë mijë e njëqind e  
shtatëdhjetë) lekë pa TVSH

Afatet e lëvrimet: Nga data e lidhjes së kontratës deri më 17 dhjetor 2018.

Publikime të mëparshme: *po* Buletini i Njoftimeve Publike *nr. 32 datë 13 Gusht 2018*

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “ALBANIA MOTOR COMPANY” shpk me numër NIPT K41829010I me ofertë ekonomike 163.642.500 (njëqind e gjashtëdhjetë e tre milion e gjashtë qind e dyzetë e dymijë e pesëqind) lekë pa TVSH.
2. Operatori ekonomik “HYUNDAI AUTO ALBANIA” shpk me numër K62420006T me ofertë ekonomike 169.500.000 (njëqind e gjashtëdhjetë e nëntë milion e pesëqind mijë) lekë pa TVSH.
3. Operatori ekonomik “MEKTRIN MOTORS” shpk me numër K51408501P me ofertë ekonomike 141.750.000 (njëqind e dyzetë e një milion e shtatëqind e pesëdhjetë mijë) lekë

pa TVSH.

4. Operatori ekonomik “EURO PARTNERS” shpk me numër L02416002I me ofertë ekonomike 181.500.000 (njëqind e tetëdhjetë e një milion e pesëqind mijë) lekë pa TVSH.
5. Operatori ekonomik “RRAPI MYZEQARI” p.f me numër K44327401O nuk ka paraqitur ofertë ekonomike.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori ekonomik “MEKTRIN MOTORS” shpk me numër K51408501P me ofertë ekonomike 141.750.000 (njëqind e dyzetë e një milion e shtatëqind e pesëdhjetë mije) lekë pa TVSH.

*“1. Ofertuesi nuk plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 1 të seksionit 2.3 “Kapaciteti Teknik” të DT, sepse ka paraqitur faturë tatimore shitje me OSHEE sh.a për autovinc dhe jo për mallra të ngjashme me objektin e prokurimit, si dhe me vlerë më të vogël se 30% e fondit limit për këtë lot. Po ashtu, ofertuesi ka paraqitur 4 fatura tatimore shitje të cilat janë fotokopje të panoterizuara, si dhe nuk ka paraqitur as vertetim për realizim me sukses të kontratës në rastin kur nuk arrin ta vërtetojë përmbushjen e kriterit me faturat tatimore. 2. Ofertuesi nuk plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 2 të seksionit 2.3 “Kapaciteti Teknik” të DT, sepse një nga dokumentat e paraqitur për këtë kriter është në gjuhë të huaj, ndërsa dokumenti tjetër nuk është origjinal ose kopje e noterizuar e tij. Po ashtu, ofertuesi ka paraqitur vetëm autorizim lëshuar për Mektrin shpk, duke mos vërtetuar lidhjen midis lëshuesit të autorizimit dhe prodhuesit të automjetit për autoambulancën. 3. Ofertuesi nuk plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 5 të seksionit 2.3 “Kapaciteti Teknik” të DT, sepse ka paraqitur vetëm një katalog teknik në gjuhë të huaj të automjetit për autoambulancën që oferton, të papërkthyer e të panoterizuar, si dhe nuk ka paraqitur katalogë teknike / broshura për kabinën e pacientit të autoambulancës.”.*

2. Operatori ekonomik “EURO PARTNERS” shpk me numër L02416002I me ofertë ekonomike 181.500.000 (njëqind e tetëdhjetënjë milion e pesëqind mijë) lekë pa TVSH.

*“1. Ofertuesi nuk plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 2 të seksionit 2.3 “Kapaciteti Teknik” të DT, sepse nuk ka paraqitur autorizim lëshuar nga prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi i automjetit për autoambulancën, për tregtimin nga Euro Partners shpk. Ofertuesi ka paraqitur vetëm autorizim lëshuar nga prodhuesi i kabinës së pacientit të autoambulancës, në të cilën nuk përfshihet tregtimi i automjetit.”.*

3. Operatori ekonomik “RRAPI MYZEQARI” p.f me numër K44327401O nuk ka paraqitur ofertë ekonomike.

*“1. Ofertuesi nuk ka paraqitur asnjë nga dokumentat e kërkuar në DT. 2. Ofertuesi nuk ka paraqitur ofertë ekonomike.*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë “ALBANIA MOTOR COMPANY” shpk, me adresë: Autostrada Tiranë – Durrës, Km 8, Tiranë, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 163.642.500 (njëqind e gjashtëdhjetë e tre milion e gjashtëqind e dyzetë e dy mijë e pesëqind) Lekë pa TVSH është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë autoritetit kontraktor, Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentet e tenderit, menjëherë nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 06.09.2018

Ankesa: po.

**TITULLARI I ORGANIT QENDROR BLERËS  
DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

